



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr. __, datë __.__.2014

PER KUSHTET E PERDORIMIT TE FREKUENCAVE DHE KERKESAT
TEKNIKE PER PAJISJET RADIO QE PERDOREN PA AUTORIZIM
INDIVIDUAL

Miratur me Vendim Nr. _____, datë __.__.2014 i Keshillit Drejtues

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i rregullores është hartimi i kushteve për përdorimin e frekuencave që përdoren pa autorizim individual si dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdorin këto frekuenca.

Neni 2

Objekti

Kjo Rregullore zbatohet nga përdoruesit e pajisjeve radio transmetuese sipas listes së mëposhtme. Këto pajisje janë tipe të miratuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9918, i ndryshuar dhe që përdoren vetëm në frekuencat “kolektive”, të përcaktuara në Aneksin e kësaj Rregulloreje, pa autorizim individual :

- 1) pajisje fundore DECT;
- 2) pajisje fundore të lëvizshme dhe pajisje të tjera fundore për GSM, UMTS, rrjetet dixhitale të lëvizshme me brez të gjerë dhe sistemet tokësore të afte për ofruar shërbime të komunikimeve elektronike.
- 3) radiotransmetues të brezit CB dhe PR 27;
- 4) pajisje radio me rreze të shkurtër veprimi, me përjashtim të radio transmetuesve në frekuencën 468.200 MHz;
- 5) pajisje telekomandimi për modele avionësh lodër;
- 6) pajisje për identifikim automatik të mjeteve, që përdoren në hekurudhat (AVI);
- 7) pajisje të transmetimit të të dhënave me brez të gjërë (RLAN/WLAN)
- 8) alarme me fuqi të vogël që përdoren për siguri si dhe alarme sociale;
- 9) pajisje për detektim të lëvizjeve dhe pajisje alarmi;
- 10) pajisje identifikimi të radio frekuencave (RFID);
- 11) sisteme peixher lokale (on-site);
- 12) altoparlatë pa tel (wireless), pajisje monitorimi për t'u vendosur në vesh, pajisje ndihmëse për dëgjim të dëmtuar, si dhe radio mikrofona;
- 13) pajisje mjeksore me fuqi shumë të vogël;
- 14) pajisje fundore për komunikime të lëvizshme satelitore, të cilat punojnë nën

kontrollin e nje sistemi satelitor dhe qe kane nje pjese transmetuese dhe nje pjese marrese, si dhe pajisje fundore per komunikime te levizshme te cilat jane te rregjistruara ne nje sistem satelitor dhe qe kane vetem pjesen transmetuese, me perjashtim te stacioneve ne bord te anijeve dhe avioneve qe operojne ne brezin e frekuencave 1626.5-1645.5 MHz dhe 1646.5-1660.5 MHz.

- 15) Stacione OmniTRACS ne sistemin EUTELTRACS;
- 16) pajisje fundore per rrjetet fikse me akses pa tel te lidhura me nje nyje komutimi qendrore, per te cilët AKEP ka dhënë një Autorizim sipas ligjit për komunikimet elektronike, nr. 9918, i ndryshuar;
- 17) radiotransmetues PMR446;
- 18) pajisje dixhitale PMR446;
- 19) pajisje të transportit rrugor dhe pajisje telematike të trafikut;
- 20) pajisje fundore HEST¹ and LEST² per komunikime fikse satelitore.
- 21) Pajisje fundore te rrejtit GSM-R
- 22) Stacione të lëvizshëm tokesore satelitorë qe operojne ne frekuencat e perbashketa 14-14.5 GHz, të vendosur në bordin e avionëve (AES)
- 23) transmetues FM me fuqi të vogël;
- 24) pajisje UWB dhe ;
- 25) stacione tokesore ne platformat e levizshme (ESOMP) per komunikimet fikse satelitore ne brezin e frekuencave 29.5-30 GHz.

Neni 3

Baza Ligjore

AKEP për hartimin e kësaj rregulloreje mbështetet në:

1. Ligjin Nr. 9918 datë 14.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjat ë), f) dhe p) të nenit 8, pika 5 e nenit 65, pika 2 e nenit 67 e në vijim.
2. Vendimet dhe rekomandimet e Komitetit European të Radiokomunikacioneve (ERC) dhe komitetit European të Komunikimeve Elektronike (ECC).

Neni 4

Zotërimi dhe përdorimi i radio transmetuesve

Përdorimi i frekuencave dhe zotërimi i pajisjeve radio të nenit 2 që përdorin këto

¹ Terminale satelitore me EIRP te madhe

² Terminale satelitore me EIRP të vogël

frekuenca, nuk kanë nevojë për Autorizim Individual. Për përdorimin e këtyre radio transmetuesve duhet të zbatohen dispozitat e vecanta të mëposhtme.

Dispozita të vecanta për përdorimin

Neni 5

Përdorimi i telefonave pa tel:

Telefonat pa tel, DECT, pajisje të transmetimit me brez të gjërë (RLAN/WLAN) Rrjete fikse me brez te gjere te aksesit pa tel, do të plotësojnë:

1. Këtyre pajisjeve mund t'ju vendosen vetëm antena të tipit me të cilin ato janë provuar për të plotësuar kërkesat thelbësore. Sidoqoftë, pajisjeve DECT lejohet t'ju vendoset një antenë me amplifikim maksimal 12 dBi.
2. Nuk lejohet lidhja e amplifikatorëve ndërmjet pajisjes dhe antenës ose stacionit bazë dhe antenës, në se nuk është provuar që ky kombinim i pajisjeve është në përputhje me kërkesat thelbësore.

Neni 6

Pajisjet fundore të lëvizëshme

Pajisjet fundore të lëvizshme, terminale të tjera për GSM, UMTS, rrjete dixhitale te levizshem me brez te gjere dhe sisteme tokesore qe jane te afta per te ofruar sherbime te levizshme satelitore duke iu referuar paragrafit 15 nen seksionin 1, stracionet OmniTRACS, dhe pajisjet fundore satelitore HEST, pajisjet satelitore fundore ESOMP dhe pajisjet fundore te rrjetit GMS-R.

1. Këto pajisje fundore nuk duhet të përdoren në bordin e avionëve ose në cdo pajisje tjetër që përdoret në aviacion, me përjashtim të :
 - a) Ne lartesine minimale prej 3000 m , eshte e lejuar te perdoren pajisje fundore të rrjetit GSM 1800, përdorimi i të cilëve është lejuar në bordin e avionëve të pajisur me një stacion bazë në përputhje me Vendimin e ECC: ECC/DEC/(06)07 dhe ;
 - b) pajisjet fundore ESOMP mund te perdoren ne bordin e anijeve ne rrjetin satelitor duke u referuar ne vendimin ECC/DEC/(13)01.
2. Pajisjet fundore satelitore HEST dhe ESOMP nuk duhet të përdoren ne afersi te zones aeroportuale . Distanca minimale e lejuar ne zonen aeroportuale (nga gardhi rrethues) bazohet ne fuqine rrezatuese:

Fuqia e rrezatuar dBW EIRP e pajisjes fundore satelitore	>34-50	>50-55.3	>55.3-57	>57-60
Distanca e sigurise nga zona aeroportuale (nga gardhi rrethues)	500 m	1800 m	2300 m	3500 m

Neni 7

Pajisjet radiotelefona.

Radiotelefonat PR 27 dhe radiotelefonat CB do të plotësojnë:

1. Këta radiotelefona nuk duhen përdorur në bordin e avionëve apo në cfardo pajisje tjetër që përdoret në aviacion.
2. Nuk lejohet lidhja e amplifikatorëve ndërmjet radiotelefonit dhe antenës së tij, nëqoftëse nuk është provuar që një kombinim i tillë është në përputhje me kërkesat thelbësore.
3. Me këta radiotelefona mund të përdoret një antenë e vecantë me amplifikim maksimal 3 dBd.
4. Parametrat e vendosura në radiotelefonat CB nuk duhen ndryshuar për të punuar nëfrekuenca të tjera dhe me fuqi të transmetuesit të ndryshme nga vlerat e dhëna në pikën 4 në Aneks.

Neni 8

Stacionet tokësore satelitore

Stacionet tokësore satelitorë të vendosur në bordin e avionëve do të plotësojnë:

1. Një stacion tokësor satelitor në frekuencat 14 - 14.5 GHz, i vendosur në bord të avionit nuk duhet të përdoret më afër se distanca 100 m nga pista e aeroportit ose kulla e kontrollit.

Neni 9

Pajisjet radiotranmetues të tjerë

Radio tranmetues të tjerë ndaj të cilëve duhet zbatuar kjo Rregullore:

1. Një radio tranmetues nuk duhet përdorur në bordin e avionëve ose në cdo pajisje tjetër që përdoret në aviacion, me përjashtim të rastit kur kjo gjë lejohet në frekuencat e përcaktuara në Aneksin e kësaj Rregulloreje.
2. Asnjë amplifikator nuk duhet lidhur ndërmjet një radio tranmetuesi dhe antenës së tij, nëqoftëse nuk është provuar që ky kombinim pajisjesh është në përputhje me kërkesat thelbësore.

Dispozita të tjera

Neni 10

Pjesë të rregullores

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë edhe ankeset bashkëngjitur.

Neni 11

Informimi dhe publikimi

Kjo Rregullore është pjesë e Rregulloreve të nxjerra nga AKEP dhe publikohet në faqen e internetit të AKEP-it. Sipërmarrësit janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje. Vendimet dhe Rekomandimet e Komitetit European të Radiokomunikacioneve (ERC) dhe Komitetit European të Komunikimeve Elektronike (ECC), të cilat përmenden në këtë Rregullore, mund të merren në faqen e internetit të Zyrës Europiane të Radiokomunikacioneve (ERO), në adresën <http://www.ero.dk>.

Neni 12

Zbatimi i rregullores

Përdorimi i frekuencave dhe pajisjeve objekt i kesaj rregulloreje në kundërshtim me percaktimet e vendosura përbën kundravajtje administrative dhe zbatohen nenet 134 e në vijim të ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektoronike në Republikën e Shqipërisë, ”, i ndryshuar .

Neni 13

Shfuqizimi

Rregullorja Nr. 11 Date 08. 01. 2010 “Per kushtet e perdorimit te frekuencave dhe kerkesat teknike per pajisjet radio qe perdoren pa autorizim individual” shfuqizohet.

Neni 14

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

ANEKS 1

FREKUENCAT E CAKTUARA NGA AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR RADIO TRANSMETUESIT E PËRMENDUR NË NENIN 1

Përdorimi i radio transmetuesve të përmendur më poshtë duhet të bëhet gjithashtu vetëm në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave.

Fuqia efektive e rrezatuar

Fuqia efektive e rrezatuar e një radio transmetuesi është shuma e fuqisë së transmetuesit dhe amplifikimit të antenës duke zbritur shuarjen e linjës së transmetimit. Fuqia efektive e rrezatuar përcaktohet në njësi W ERP referuar një antene dipol (amplifikimi dBd) ose në njësi W EIRP referuar një antene izotropike (amplifikimi dBi).

Shmangia e interferencës në frekuencat për përdorim të përbashkët (kolektive)

Frekuencat kolektive përdoren nga disa përdorues. Si rrjedhojë, në këto frekuenca mund të shfaqen interferenca të shkaktuara nga transmetuesë të tjerë të përjashtuar nga autorizimi apo dhe radio transmetuesë të autorizuar.

1. RADIOTRANSMETUES PA TEL (CORDLESS) CT1 QE JANE MARRE NE PERDORIM ME 31 DHJETOR 2013, RADIOTRANSMETUES PA TEL (CORDLESS) CT2 QE JANE MARRE NE PERDORIM ME 31 DHJETOR 2014 DHE PAJISJET DECT

Telefonat CT1, pjesa fikse	959.0125 MHz + (0...39) x 25 kHz
Telefonat CT1, pjesa e levizshme	914.0125 MHz + (0...39) x 25 kHz
Telefona CT2	864.150 MHz + (0...39) x 100 kHz
Pajisjet DECT	1881.792 MHz + (0...9) x 1.728 MHz

2. PAJISJET FUNDORE TË LËVIZSHME DHE PAJISJE TË TJERA FUNDORE PËR GSM, UMTS DHE SISTEME TOKESORE TE AFTA PER TE OFRUAR SHERBIME TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Sisteme tokesore qe mundesojne ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike	832-862 MHz
Rrjeti GSM 900:	880.200 MHz + (0...173) x 200 kHz
GSM 1800:	1710.200 MHz + (0...373) x 200 kHz
UMTS:	1900 - 1980 MHz and 2020 – 2025MHz ³
LTE	1710.100 MHz – 1784.900 MHz

³ Gjërësia e kanalit sipas Vendimit ERC/DEC/(99)25

Sisteme tokesore qe mundesojne ofrimin
e sherbimeve te komunikimeve elektronike

2500 – 2620 MHz

Sisteme tokesore qe mundesojne ofrimin
e sherbimeve te komunikimeve elektronike

3410 – 3590 MHz

3. RADIO TELEFONAT CB DHE PR 27⁴

Kanali	Frekuenca	Kanali	Frekuenca	Kanali	Frekuenca
1	26.965 MHz	14	27.125 MHz	27	27.275 MHz
2	26.975 "	15	27.135 "	28	27.285 "
3	26.985 "	16	27.155 "	29	27.295 "
4	27.005 "	17	27.165 "	30	27.305 "
5	27.015 "	18	27.175 "	31	27.315 "
6	27.025 "	19	27.185 "	32	27.325 "
7	27.035 "	20	27.205 "	33	27.335 "
8	27.055 "	21	27.215 "	34	27.345 "
9	27.065 "	22	27.225 "	35	27.355 "
10	27.075 "	23	27.255 "	36	27.365 "
11	27.085 "	24	27.235 "	37	27.375 "
12	27.105 "	25	27.245 "	38	27.385 "
13	27.115 "	26	27.265 "	39	27.395 "
				40	27.405 "

Fuqia e transmetuesit dhe fuqia efektive e rrezatur (ERP) e pajisjes me antene integrale:

- 1) ne modulimin e frekuences ⁵ ≤ 4 W (ketyre pajisjeve u referoheshin me perpara si PR 27)
- 2) tek modulim me dy breza anesore ⁶ fuqia e barteses eshte ≤ 4 W dhe,
- 3) tek modulimi me nje brez anesor fuqia⁷ ne modulim pik eshte ≤ 12 W. Gjërësia e kanalit 10kHz

⁴ ECC DECISION ECC/DEC/ (11)03

⁵ FM , 3GE

⁶ AM DSB,A3E

⁷ SSB , J3E dhe R3E

4 PAJISJE ME RREZE TË SHKURTËR VEPRIMI⁸

Aplikimet zanore dhe aplikime video me rreze të shkurtë veprimi lejohen vetëm në frekuencat mbi 2.4 GHz, me përjashtim kur përcaktohet ndryshe. Lejohet përdorimi i pajisjeve me rreze të shkurtë veprimi edhe në avionët ose te cdo pajisjeje tjetër që perdoret ne aviacion. Në brezat e frekuencave ku gjërësia e kanalit është përcaktuar, frekuenca qëndrore e kanalit të parë është e larguar me gjysëm kanali nga skaji i poshtëm i brezit të frekuencavee.

26.825 MHz

26.845 “

26.865 “

26.885 ”

26.905 ”

26.925 ”

26.935 ”

26.945 ”

26.995 ”

27.045 ”

27.095 ”

27.145 ”

27.195 ”

27.255 ”

Fuqia e transmetuesit të pajisjes që përdor një antenë të jashtme ≤ 500 mW dhe fuqia efektive e rrezatuar te pajisjes me antene integrale ≤ 100 mW ERP. Gjërësia e kanalit 10 kHz.

26.957 – 27.283 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Lejohen aplikimet zanore dhe audio.

40.660 – 40.790 MHz

Fuqia e transmetuesit të pajisjes që përdor një antenë të jashtme ≤ 500 mW dhe fuqia efektive e rrezatuar të pajisjes me antenë integrale ≤ 100 mW ERP.

40.660 – 40.700 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Lejohen aplikime zanore dhe audio.

⁸ Pajisje me rreze të shkurtë veprimi janë, ndër të tjera, pajisje për kontroll, alarm, telemetri, telekomandë dhe transmetim të dhënash, alarme sociale dhe aplikime video. Zbatohen pjesë të Aneksve 1 dhe 8, të Rekomandimit CEPT/ERC/REC 70-03, dhe pjesë të Vendimeve ERC/DEC/(01)03, ERC/DEC/(01)10 and ERC/DEC/(01)12. Vendimi i Komisionit 2006/771/EC, Aneksi teknik I vlefshëm ne vednimin 2013/752/EU..

138.200 – 138.450 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 500\text{mW ERP}$. Cikli i punës $\leq 10\%$ ¹¹ .
169.400 – 169.475 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 500\text{ mW ERP}$.Gjeresi kanali $\leq 50\text{ kHz}$ $\leq 50\text{ kHz}$.Cikli i punes $\leq 1\%$. ⁹
169.400 – 169.487 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 10\text{ mW ERP}$. Cikli i punes $\leq 0.1\%$. ¹¹
169.4875 – 169.5875 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 10\text{ mW ERP}$. Cikli i punes $\leq 0.001\%$. ^{11, 10}
169.5875 – 169.8125 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 10\text{ mW ERP}$.Cikli i punes $\leq 0.1\%$.
433.050 – 434.790 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 25\text{mW ERP}$. Cikli i punës $\leq 10\%$ ^{12,11} . Lejohen aplikimet zanore.Lejohen aplikimet dixhitale zanore dhe video.
433.050 – 434.790 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 1\text{mW ERP}$. Densiteti i fuqisë spektrale të transmetimit nën - 13 dBm/10 kHz ERP për transmetuesit me brez të gjërë. Nuk ka kufizime të ciklit të punës. Lejohen aplikimet zanore me një protokoll aksesi ¹³ të pershtatshem me një mates kohe automatic te barteses (automatic carrier time-out timer).
434.040– 434.790 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 10\text{ mW ERP}$. Gjërësia max. e kanalit 25 kHz. S'ka kufizime të ciklit të punës. Lejohen aplikimet zanore me një protokoll aksesi ¹² te pershtatshem me një nje mates kohe automatic te barteses (automatic carrier time-out timer)
468.200 MHz	Fuqia e transmetuesit $\leq 500\text{ mW}$ dhe fuqia e rrezatuar $\leq 500\text{ mW ERP}$. Brezi I transmetimit max. 25 kHz.
863.000 – 870. 000 ¹³	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 25\text{ mW ERP}$. Cikli i punës $\leq 0.1\%$ ¹³ „ ose një protokoll i përshtatshëm aksesi ¹³ . Gjërësia e kanalit $\leq 100\text{kHz}$ ¹⁷ . Modulim FHSS ¹⁸ . Numri i kanaleve ≥ 47 . . Lejohen aplikimet zanore.Lejohen aplikimet dixhitale zanore dhe video.
863.000 – 870.000 ¹⁴	⁹ Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 25\text{ mW ERP}$ ¹⁹ . Densiteti spektral i fuqisë $\leq - 4.5\text{ dBm}/100\text{ kHz}$ ²⁰ Cikli i punës $\leq 0.1\%$ ¹¹ ose një protokoll aksesi ¹³ përshtatshëm ²¹ . DSSS ²² dhe modulime të tjera me brez të gjërë, me përjashtim të FHSS.
868.000 – 868.600 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 25\text{ mW ERP}$. Cikli i punës $\leq 1\%$ ose një protokoll i përshtatshëm aksesi ²¹ . Lejohen aplikimet zanore.dhe audio.
868.700 – 869.200 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 25\text{ mW ERP}$. Cikli i punës $\leq 1\%$ ose një protokoll i përshtatshëm aksesi ¹²¹ . Lejohen aplikimet zanore dhe video.Lejohen aplikimet dixhitale video.
869.400 – 869.650 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 500\text{ mW ERP}$. Gjërësia e kanalit 25 kHz. Cikli i punës $\leq 10\%$ ose një protokoll aksesi i përshtatshëm ¹²¹ .

⁹ Cikli i punës përcaktohet si raport, i shprehur në përqindje, i maksimumit në punë të transmetuesit, në raport me një orë kohe.

¹⁰ Midis ores 00:00 dhe 06:00 nje cikel pune mund te jete $\leq 0.1\%$.

¹¹ Cikli i punës $\leq 10\%$ hyri në fuqi për radio transmetuesit që futen në treg nga 1 Prill 2003, më parë nuk kishte kufizim të ciklit të punës.

¹² Një protokoll i përshtatshëm aksesi është përcaktuar në standardin ETSI EN 300 220

¹³ Nenbrezat 868.600-868.700 MHz, 869.200-869.250 MHz, 869.250-869.300 MHz, 869.300 – 869.400 MHz, 869.650 – 869.700 MHz nuk jane perfshire, sepse jane te destinuar per siguri dhe alarme sociale (shih seksionin 8 te Aneksit)

Brezi mund të përdoret si një kanal për transmetim të dhënash me shpejtësi të madhe. Lejohen aplikimet zanore dhe video. Lejohen aplikimet dixhitale video.

869.700 – 870.000 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 5 mW ERP. Lejohen aplikime zanore me një protokoll aksesi¹² të përshtatshëm²¹.

869.700 – 870.000 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 mW ERP. Cikli i punës 1% ose një protokoll aksesi¹² i përshtatshëm. . Lejohen aplikimet zanore. Lejohen aplikimet dixhitale zanore dhe video.

2400.000 – 2483.500 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW EIRP.

5725 – 5875 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 mW EIRP.

24.00 – 24.25 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW EIRP.

57 – 64 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW EIRP. Fuqia e transmetuesit ≤ 10 dBm dhe densiteti i fuqisë spektrale ≤ 13 dBm/MHz.

61.00 – 61.50 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW EIRP.

122 – 123 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW EIRP.

244 – 246 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW EIRP.

Breza të frekuencave kolektive me kufizime lidhur me pjesë individuale të pajisjeve

230.000 – 231.000 MHz

Brez i frekuencave kolektive për alarme sociale dhe për pajisje me reze të shkurtë. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW ERP.

868.150 – 868.650 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW ERP për pajisje jo-specifike me reze të shkurtër.

5. PAJISJE TELEKOMANDIMI PËR PËRDORIM ME AVIONË LOJE¹⁴

34.995 -35.225 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW ERP.

¹⁴ Pajisje me reze të shkurtër, Rekomandimi ERC CEPT/ERC/REC 70-03, zbatim i pjesëve të Aneksit 8, Vendimi ERC ERC/DEC/(01)11

6. PAJISJE PËR IDENTIFIKIM AUTOMATIK TË MJETEVE NË HEKURUDHA (AVI)¹⁵

2447.0 MHz 2448.5 MHz 2450.0 MHz 2451.5 MHz 2453.0 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW EIRP. Gjërësia e kanalit 1.5 MHz

7. PAJISJE ME BREZ TË GJËRË PËR TRANSMETIM TË DHËNASH (RLAN/WLAN)¹⁶

2400.000 – 2483.500 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW EIRP, densiteti spektral i fuqisë të transmetimit duhet të jetë ≤ 10 mW/1 MHz EIRP.

5150.000 – 5250.000 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 200 mW EIRP, densiteti spectral i fuqisë të transmetimit duhet të jetë ≤ 10 mW/1 MHz EIRP. Lejohet vetëm përdorim brenda godinës (indoor).

5250.000 – 5350.000 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 200 mW EIRP, densiteti spectral i fuqisë të transmetimit duhet të jetë ≤ 10 mW/1 MHz EIRP. Lejohet vetëm përdorim brenda godinës (indoor).

5470.000 – 5725.000 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 1 W EIRP, densiteti spectral i fuqisë të transmetimit duhet të jetë ≤ 50 mW/1 MHz EIRP. Lejohet përdorimi brenda dhe jashte godine.

57.0 – 66.0 GHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 40 dBm EIRP, densiteti spectral i fuqisë të transmetimit duhet të jete 13 dBm/MHz EIRP. Nuk lejohen instalimet fikse jashte godine.

Pajisjet RLAN që punojnë në brezat 5250 – 5350 MHz dhe 5470 – 5725 MHz duhet të përdorin kontroll të fuqisë së transmetimit, i cili siguron një faktor zvogëlimi të fuqisë prej të paktën 3 dB në fuqinë maksimale të lejuar të sistemit.

Nëqoftëse kontrolli i fuqisë së daljes nuk përdoret, maksimumi i lejuar nënkupton EIRP dhe

¹⁵ Pajisje me rreze të shkurtër, Rekomandimi ERC CEPT/ERC/REC 70-03, zbatimi pjesëve të Aneksit 4

¹⁶ Pajisje me rreze të shkurtër, Rekomandimi CEPT/ERC/REC 70-03, zbatim i pjesëve i Aneksit 3 dhe Vendimi i ERC ERC/DEC/(01)07

dhe Vendimi i ECC ECC/DEC/(04)08. Vendimet e Komisionit 2005/513/EC dhe 2007/90/EC. Vendimi I komisionit 2066/771/EC, Aneksi teknik i vlefshëm është në vendimin 2013/752/EU.

densiteti korespondues nënkupton që kufijtë e densitetit EIRP duhet të reduktohen me 3 dB.

Pajisjet RLAN që punojnë në brezat 5250 – 5350 MHz dhe 5470 – 5725 MHz duhet të përdorin teknikat e zvogëlimit që përpunohen me kërkesat e detektimit, ato operacionale dhe të përgjigjes që përshkruhen në Standardin EN 301 893.

Për përdorimin e frekuencave të mesiperme, është i detyrueshëm akti i raportimit pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, 30 dite para përdorimit të tyre, sipas formularit të aplikimit në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

8. ALARMET ME FUQI TË VOGËL PËR SIGURI DHE ALARME SOCIALË¹⁷

Në brezat e frekuencave ku gjërësia e kanalit është e përcaktuar, frekuenca qëndrore e kanalit të parë është në distancë gjysëm kanali nga skaji i poshtëm i brezit të frekuencave.

142.250 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 1 mW ERP. Brezi total i emetimit ≤ 25 kHz
169.4000 – 169.4750 MHz	Sisteme të leximit automatik të matjeve. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 50 kHz. Cikli i punës $\leq 10\%$ ¹⁶
868.600 – 868.700 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 25 kHz. Cikli i punës $\leq 1\%$ ¹⁶ . Brezi i frekuencave mund të përdoret si 1kanal për transmetim të dhënash me shpejtësi të madhe.
869.250 – 869.300 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP Gjërësia e kanalit 25 kHz. Cikli i punës $\leq 0.1\%$ ¹⁶ .
869.300 – 869.400 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Gjërësia e kanalit 25 kHz. Cikli i punës $\leq 1.0\%$ ¹⁶ .
869.650 – 869.700 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 mW ERP. Gjërësia e kanalit 25 kHz. Cikli i punës $\leq 10\%$.
869.200 – 869.250 MHz	Vetëm për alarme sociale. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Gjërësia e kanalit 25 kHz. Cikli i punës $\leq 0.1\%$ ¹⁶ .

¹⁷ Pajisje me reze të shkurtë, Rekomandimi CEPT/ERC/REC 70-03, zbatim i pjesshëm i Anekseve 2 dhe 7, Vendimet e ECC ECC/DEC/(05)02. Vendimi I komisionit 2006/771/EC, Aneksi teknik I vlefshëm është në vendimin 2013/752/EU

9. PAJISJE PËR DETEKTIM LËVIZJEJE DHE PAJISJE ALARMI¹⁸

2400.000 – 2483.500 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 mW EIRP.
9500 – 9975 MHz .	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 mW EIRP.
10.45 – 10.50 GHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW EIRP.
10.5 – 10.6 GHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 mW EIRP. Cikli i punes $\leq 10\%$. Lejohet perdorimi vetem brenda godines.
13.40 – 14.00 GHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 mW EIRP.
17.1 – 17.3 GHz	Ground based synthetic aperture radars (GBSAR).Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 26 dBm. Protokoll aksesi i pershtatshem. ¹⁹
24.00 – 24.25	GHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW EIRP.
4.5 – 7.0 GHz	Radarë të matjes së nivelit të rezervuarëve. Fuqia maksimale e rrezatuar jashtë rezervuarit -41.3 dBm EIRP dhe brenda rezervuarit +24 dBm EIRP.
8.5 – 10.6 GHz	Radarë të matjes së nivelit të rezervuarëve. Fuqia maksimale e rrezatuar jashtë rezervuarit -41.3 dBm EIRP dhe brenda rezervuarit +30 dBm EIRP.
24.05 – 27.00 GHz	Radarë të matjes së nivelit të rezervuarëve. Fuqia maksimale e rrezatuar jashtë rezervuarit -41.3 dBm EIRP dhe brenda rezervuarit $\leq +43$ dBm EIRP.
57 – 64 GHz	Radarë të matjes së nivelit të rezervuarëve. Fuqia maksimale e rrezatuar jashtë rezervuarit -41.3 dBm EIRP dhe brenda rezervuarit $\leq +43$ dBm EIRP.
75 – 85 GHz	Radarë të matjes së nivelit të rezervuarëve. Fuqia maksimale e rrezatuar jashtë rezervuarit - 41.3 dBm EIRP dhe brenda rezervuarit $\leq +43$ dBm EIRP.
6.0 – 8.5 GHz 24.05 – 26.50 GHz 57- 64 GHz 75 – 85 GHz	Radar te matjes se nivelit te rezervuareve. ²⁰

¹⁸ Pajisje me rreze të shkurtër, Rekomandimi ERC CEPT/ERC/REC 70-03, zbatohen pjesë të Aneksit 6, Vendimi ERC ERC/DEC/(01)08.Vendimi I ERC ERC/DEC/(01)08.Vendimi I komisionit 2006/771/EC, aneksi teknik I vlefshem eshte ne vendimin 2013/752/EU.

¹⁹ Nje protokoll aksesi I pershtatshem eshte percaktuar ne standardet e ETSI EN 300 440.

²⁰ Kushtet teknike dhe kufizimet gjeografike jane percaktuar ne standardin EN 302 729 dhe vendimin e ECC ECC/DEC/(11)02

Breza te perbashket frekuencash te kufizuar ne lidhjer me pjeset individuale te pajisjes:

10.50 – 10.55 GHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW EIRP.

10. PAJISJE RADIO FREKUENCË PËR IDENTIFIKIM (RFID)²¹

865.000 – 865.600 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 100 mW ERP. Gjërësia e kanalit 200 kHz²².

865.600 – 867.600 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 2 W ERP. Gjërësia e kanalit 200 kHz.

867.600 – 868.000 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW ERP. Gjërësia e kanalit 200 kHz.

865.000 – 868.000 MHz Brezat e frekuences se interrogatorit:
865.600 – 865.800 MHz
866.200 – 866.400 MHz
866.800 – 867.000 MHz
867.400 – 867.600 MHz
Fuqia efektive e rrezatuar e interrogatorit ≤ 2 W ERP.

2446.0 – 2454.0 MHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW EIRP. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 4 W EIRP vetëm në përdorime brenda ambienteve (indoors) dhe cikli i punës $\leq 15\%$.²³

11. SISTEME PEIXHER LOKALË (ON SITE)

27.720 MHz	27.820 MHz	27.920 MHz
27.740 MHz	27.840 MHz	27.940 MHz
27.760 MHz	27.860 MHz	30.300 MHz
27.780 MHz	27.880 MHz	40.680 MHz
27.800 MHz	27.900 MHz	

Fuqia e transmetuesit ≤ 5 W dhe fuqia efektive e rrezatuar e pajisjes me antenë integrale ≤ 5 W ERP. Gjërësia e kanalit 10 kHz.

²¹ Rekomandimi CEPT/ERC/REC 70-03, zbatohen pjesë të Aneksit 11. Vendimimi I komisionit 2006/804/EC. Vendimi I komisionit 2006/771/EC, aneksi teknik I vlefshem eshte ne vendimin 2013/752/EU.

²² Protokollli I aksesit dhe ndarja e kanaleve jane bazuar ne standardin EN 302 208-2 V1.1.1

²³ Cikli i punës duhet të jetë $\leq 15\%$ brenda cdo periudhe prej 200 msec. (d.m.th. 30 msec punë dhe 170 msec pushim)

12. ALTOPARLANTË PA TEL, PAJISJE PËR MONITORIM ME ANË TË DËGJIMIT NË VESH, KUFJE DËGJIMI, PAJISJE NË NDIHMË TË ATYRE QË NUK DËGJOJNË MIRË, RADIO TELEFONA HELMETE DHE RADIO MIKROFONA²⁴

Në brezat e frekuencave ku gjërësia e kanalit është e përcaktuar, frekuenca qëndrore e kanalit të parë duhet të jetë në distancë gjysëm kanali nga skaji i poshtëm i brezit të frekuencave.

31.100 MHz	33.500 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP.
32.100 MHz	36.700 MHz	Gjërësia totale e dhënies max. 200 kHz
32.900 MHz	37.100 MHz	
42.400 – 43.600 MHz		
169.4000 – 169.4750 MHz		Gjërësia e kanalit ≤ 50 kHz. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Pajisje ndihmëse për dëgjim difektoz. Përdorim i përbashkët me pajisjet me rreze të shkurtër.
169.4875 – 169.5875 MHz		Gjërësia e kanalit ≤ 50 kHz. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Vetëm pajisje ndihmëse për dëgjim difektoz.
173.965 – 174.015 MHz		Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 2 mW ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 50 kHz. Vetëm pajisje ndihmëse për dëgjim difektoz.
823 – 826 MHz		Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 12 mW ERP. Radio mikrofona të vendosur në trup ≤ 60 mW ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 200 kHz. Vetëm radio mikrofona, pajisje për monitorim në vesh dhe ndihmëse për dëgjim difektoz.
826 – 832 MHz		Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 60 mW ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 200 kHz. Vetëm radio mikrofona, pajisje për monitorim në vesh dhe ndihmëse për dëgjim difektoz.
863.000 – 865.000 MHz		Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP.
864.800 – 865.000 MHz		Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 10 mW ERP. Gjërësia e kanalit max. 50 kHz. Pajisje zanore analoge me brez të ngushtë.

13. PAJISJE MJEKSORE ME FUQI SHUMË TË VOGËL²⁵

30.0 – 37.5 MHz	Aplikime për matje të presionit të gjakut. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 1 mW ERP. Cikli i punës $\leq 10\%$.
401.000 – 402.000 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 25 μ W ERP dhe një protokoll i përshtatshëm aksesit ose cikël pune $\leq 0.1\%$ dhe fuqi të rrezatuar ≤ 250 nW ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 25 kHz. Kanalet fqinje mund të kombinohen për rritjen e gjërësisë

²⁴ Pajisje me distancë të shkurtë, Rekomandimi CEPT/ERC/REC 70-03, zbatohen pjesë nga Aneksët 10 dhe 13, Vendimi ECC/DEC/(05)02, Vendimi I komisionit 2005/928/EC dhe 2008/673/EC. Vendimi I komisionit 2006/771/EC, Aneksi teknik I vlefshëm në vendimin 2013/752/EU.

²⁵ Pajisje me rreze të shkurtë, Rekomandimi CEPT/ERC/REC 70-03, Aneksi 12, Vendimi ERC/DEC/(01)17. Vendimi I Komisionit 2006/771/EC Aneksi teknik I vlefshëm është në vendimin 2013/752/EU.

se brezit deri ne 100 kHz.

402.000 – 405.000 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 25 \mu\text{W}$ ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 25 kHz. Kanalet fqinje mund te kombinohen per rritjen e gjerësisë se brezit deri ne 300 kHz.
405.000 – 406.000 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 25 \mu\text{W}$ ERP dhe një protokoll i përshtatshëm aksesi ose cikël pune $\leq 0.1\%$ dhe fuqi të rrezatuar ≤ 250 nW ERP. Gjërësia e kanalit ≤ 25 kHz. Kanalet fqinje mund te kombinohen per rritjen e gjerësisë se brezit deri ne 100 kHz.
2483.5 – 2500 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar $\leq 10\text{mW}$ EIRP. Cikli i punës $\leq 10\%$. Protokoll aksesi i përshtatshëm. Gjërësia e kanalit ≤ 1 MHz. I gjithë brezi i frekuencës mund te perdoret si nje kanal i vetem per transmetim te dhenash me shpejtesi te larte. Lejohet perdorimi i pjeseve periferike vetem brenda godines.

14. PAJISJE FUNDOR PER SISTEMET E LEVIZSHME SATELITORE²⁶

Pajisjet fundore me nje pjese transmetuese dhe nje pjese marrese:

148.00 – 150.05 MHz	Orbcomm
1610.0 – 1626.5 MHz	
1980 – 1995 MHz	Inmarsat Ventures Limited
1995 – 2010 MHz	Solaris Mobile Limited
1626.5 – 1645.5 MHz	
1646.5 – 1660.5 MHz	
1670 – 1675 MHz	

Pajisjet fundore vetem me nje pjese transmetuese :

401.620 – 401.680 MHz	Transmetuesit gjurmues qe i perkasin sistemit satelitor Argos. ²⁷
1613.8 – 1626.5 MHz	Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 30 dBm EIRP. Cikli i punës $\leq 1\%$.

15. STACIONET OMNITRACS BRENDIA SISTEMIT EUTELTRACS²⁸

14 -14.25 GHz

16. PAJISJE FUNDOR PËR RRJETET FIKSE ME AKSES PA TEL

3410 – 3790 MHz
10.150 – 10.240 GHz / 10.500 – 10.590 GHz
24.549 – 25.333 GHz / 25.557 – 26.341 GHz

²⁶ Vendimi I ERC ERC/DEC/(99)05 dhe ERC/DEC/(99)06. Vendimi I ECC ECC/DEC/(06)09, ECC/DEC/(12)01, ECC/DEC/(09)02 dhe ECC/DEC/(09)04. Vendimi I komisionit 2007/98/EC dhe 2009/449/EC dhe vendimin Nr.626/2008/EC te Parlament European dhe te Keshillit.

²⁷ Transmetues I certifikuar Argos qe perfshin platformen e identifikimit te numrit.

²⁸ Vendimi i ERC ERC/DEC/(98)17 (ARCANET) dhe ERC/DEC/(98)15 (Eutelctracs- Omnitrac).

17. TELEFONA PMR 446²⁹

446.00625 MHz + (0...7) x 12.5 kHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW ERP. Gjërësia totale e emetimit 12.5 kHz.

17A. PAJISJE DIXHITALE PMR 446³⁰

446.10625 MHz + (0...7) x 12.5 kHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW ERP. Gjërësia e kanalit 12.5 kHz

446.103125 MHz + (0.....15) x 6.25 kHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 500 mW ERP. Gjërësia e kanalit 6.25 kHz.

18. TELEMATIKË E TRANSPORTIT RRUGOR DHE TRAFIKUT³¹

5795 – 5805 MHz

Sisteme të integruar rrugorë. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 8 mW EIRP.

24.250 – 24.495 GHz

Radare për automjete. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ -11 dBm EIRP.³⁵

24.250 – 24.500 GHz

Radare për automjete. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 20 dBm EIRP (radare i perparme) dhe fuqia efektive e rrezatuar ≤ 16 dBm EIRP (radar i pasem).³²

24.495 – 24.500 GHz

Radare për automjete. Fuqia efektive e rrezatuar ≤ -8 dBm EIRP.³⁵

21.650 – 26.650 GHz

Radarët me rreze të shkurtë për automjetet (SRR). Densiteti spektral i fuqisë të transmetimeve UWB ≤ -41.3 dBm/MHz EIRP, me përjashtim të frekuencave nën 22 GHz ku densiteti spektral i fuqisë është ≤ -61.3 dBm/MHz EIRP, dhe densiteti spektral i matur si vlerë pik është 0 dBm/50 MHz EIRP. Komponenti i brezit të ngushtë 24.05 – 24.25 GHz, fuqia pik 20 dBm EIRP. Cikli i punës $\leq 10\%$ për emetim pik më të lartë se -10 dBm EIRP.³³

76 – 77.00 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar: Fuqia pik ≤ 316 W EIRP.
Fuqia mesatare ≤ 100 W EIRP. Fuqia mesatare për radarët

²⁹ Vendimet CEPT/ERC/DEC/(98)/25 dhe CEPT/ERC/DEC/(98)/26

³⁰ Vendimi ECC/DEC/(05)/12

³¹ Pajisje me rreze të shkurtë, Rekomandimi CEPT/ERC/REC 70-03, zbatohen pjesë të Aneksit 5. Vendimi I komisionit 2006/771/EC, Aneksi teknik I vlefshëm është në vendimin 2013/752/EU.

³² Standardet e harmonizuara përfshijnë terma të metejshëm për përdorimin e pajisjes.

³³ Vendimi ECC/DEC/(04)/10 dhe Vendimi I komisionit 2005/50/EC dhe 2011/485/EU gjithashtu përfshijnë terma të metejshëm për të marrë pajisjet në përdorim.

impulsive ≤ 225 mW EIRP.

77 – 81 GHz

Radarët me rreze të shkurtë për automjetet (SRR).
Densiteti spectral i fuqisë ≤ -3 dBm/MHz EIRP dhe
fuqia pik ≤ 55 dBm EIRP. Densiteti spektral i fuqisë jashtë
një automjeti ≤ -9 dBm/MHz EIRP³⁴

19. PAJISJE FUNDORE SATELITORE HEST DHE LEST PER KOMUNIKIME FIKSE SATELITORE³⁵

Pajisjet fundore HEST

14.0 – 14.25 GHz

29.5 – 30.00 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 60 dBW EIRP

Pajisjet fundore LEST

14.0 – 14.25 GHz

29.5 – 30.00 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 34 dBW EIRP

20. STACIONE TË LËVIZSHËM TOKSORE SATELITORË NE FREKUENCAT E PERBASHKETA TË VENDOSUR NË BORDIN E AVIONËVE (AES) DHE SHERBIMET “MCA” SI DHE QARKULLIMI I LIRE DHE PERDORIMI I STACIONEVE TOKESORE MBI BORDIN E ANIJEVE DUKE OPERUAR NE RRJETET E SHERBIMEVE SATELITORE FIKSE³⁶

14 – 14.5 GHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 50 dBW EIRP

21. TRANSMETUES FM ME FUQI TË VOGËL³⁷

87.5 – 108 MHz

Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 50 nW ERP.

22. PAJISJE UWB³⁸

3.1 – 4.8 GHz

Pajisje UWB që përdorin cikël pune të ulët (LDC). Pajisje fikse të instaluar
për përdorim të brendshme (indoor) dhe përdorim vetëm në mjete

³⁴ Vendimi 2004/545/EC dhe vendimi ECC/DEC/(04)03

³⁵ Vendimet ECC/DEC/(06)03 (HEST) dhe ECC/DEC/(06)02 (LEST)

³⁶ Vendimi I ECC ECC/DEC/(05)11

³⁷ Rekomandimi i ERC CEPT/ERC/REC 70-03, pjesë të aplikueshme të Aneksit 13, Vendimet e komisionit 2006/771/EC, Aneksi teknik i vlefshëm është në vendimin 2013/752/EU.

³⁸ Vendimet ECC/DEC/(06)04 dhe ECC/DEC/(07)01 dhe Vendimi i Komisionit Europian 2007/131/EC dhe 2009/343/EC. Limitet për fuqinë efektive të rrezatuar në diapazonin të ndryshme frekuencash për çdo aplikim, janë përcaktuar në standardet e harmonizuara. Futja në treg e pajisjeve UWB kërkon përdorimin e një Autoriteti Certifikues deri sa të botohet standardi i harmonizuar përkatës.

automoibile dhe hekurudhore.

- 3.1 – 4.8 GHz Pajisjet UWB qe perdorin teknikat DAA te uljes se fuqise. Densiteti spektral i fuqisë se transmetimi ≤ -41.3 dBm/MHz EIRP. Pajisje fikse te instaluar per perdorim te brendshme (indoor) dhe perdorim vetem ne mjete automoibile dhe hekurudhore. Pajisje fikse te instaluar per perdorim te ne mjete automoibile dhe hekurudhore duhet te perdorin kontrollor fuqie transmetimi (TPC) ose duhet te kene denistet spectral te fuqise ≤ -53.5 dBm/MHz EIRP .
- 4.2 – 4.8 GHz Densiteti spectral i fuqise ≤ -41.3 dBm/MHz EIRP. Për pajisjet pa teknikën e uljes së fuqisë, densiteti spektral i fuqisë është ≤ -70 dBm/MHz EIRP. Pajisje fikse te instaluar per perdorim te ne mjete automoibile dhe hekurudhore duhet te perdorin kontrollor fuqie transmetimi (TPC) ose duhet te kene denistet spectral te fuqise ≤ -53.5 dBm/MHz EIRP .
- 6.0 – 8.5 GHz Densiteti spectral i fuqise ≤ -41.3 dBm/MHz EIRP. Pajisjet e instaluar fikse vetem ne ambiente te brendshme. Pajisje fikse te instaluar per perdorim te ne mjete automoibile dhe hekurudhore duhet te perdorin kontrollor fuqie transmetimi (TPC) ose duhet te kene denistet spectral te fuqise ≤ -53.5 dBm/MHz EIRP . Pajisje fikse te instaluar per perdorim te ne mjete automoibile dhe hekurudhore duhet te perdorin kontrollor fuqie transmetimi (TPC) ose duhet te kene denistet spectral te fuqise ≤ -53.5 dBm/MHz EIRP .
- 8.5 – 9.0 GHz Pajisjet UWB qe perdorin teknikat DDA te uljes se fuqise. Densiteti spektral i fuqisë se transmetimi ≤ -41.3 dBm/MHz EIRP. Pajisjet e instaluar fikse vetëm në ambiente të brendshme.
- 2.2 – 8.5 GHz Analiza e materialeve te ndertimit dhe pajisjet per ndjeshmerine e materialeve qe perdorin teknologjine UWB.

23. STACIONET TOKESORE NE PLATFORMAT E LEVIZSHME (PAJISJET FUNDORE SATELITORE ESOMP) PER KOMUNIKIME SATELITORE FIKSE NE BREZIN E FREKUENCAVE 29.5 – 30 GHz³⁹

- 29.5 – 30.00 GHz Fuqia efektive e rrezatuar ≤ 60 dBW EIRP

³⁹ Pajisjet fundore satelitore qe operojne ne rrjetin satelitor ne perputhje me Vendimin e ECC ECC/DEC/(13)01